



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

N.T.P. "Kumanova"
Pronari: Bashkim Lumi
Therandë

Vendimi LIC/OK-KKPM: 2010/22
Ref:1009/1151/KKPM/ni

VENDIM

lidhur me aplikacionin për licencë të operatorit kabllor N.T.P. "Kumanova" - Therandë

Fakte

1. Këshilli i Komisionit të Pavarur për Media (KPM), duke vepruar në bazë të Nenit 2.5 dhe Nenit 11 të Ligjit për KPM-në Nr. 02/L-15 ka nxjerr Rregulloren e Distribuimit Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë (CIMC 2007/04) e cila ka hyrë në fuqi më datë 06 korrik 2007.
2. Në bazë të Nenit 5 të Rregullores CIMC 2007/04, operatorët aktivë kabllor kanë qenë të obliguar të regjistrohen një muaj pas miratimit të kësaj rregulloreje, ndërsa tre muaj më vonë kanë qenë të obliguar të aplikojnë për licencë të KPM-së.
3. Kandidati për operator kabllor N.T.P. "Kumanova", ka aplikuar për licencë të KPM-së për operator kabllor më 8 shtator 2010.
4. Kandidati për operator kabllor N.T.P. "Kumanova" ka filluar me ofrimin e shërbimeve për klient me datën 6 shtator 2010.

Arsyetim

5. Në pajtueshmëri me Nenin 6 të Rregullës CIMC 2007/04 operatori kabllor N.T.P. Kumanova ka paraqitur në aplikacionin e tij të gjitha të dhënat e nevojshme për licencë të KPM-së për operator kabllor.

6. Me Rregulloren për Distribuim Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë nuk përcaktohet numri i kanaleve se sa duhet të përmbajë lista e pakos

Rruga Gazmend Zajmi #1, Prishtina - Gazmend Zajmi Street #1, Pristina - Ulica Gazmend Zajmi #1, Priština

programore për një operator kabllor, prandaj Këshilli i KPM-së vlerëson se një operator kabllor mund të licencohet edhe me një numër minimal të programeve nëse ai posedon marrëveshjet valide për ritransmetimin e atyre programeve.

7. Operatori kabllorë N.T.P. "Kumanova", do të ketë të drejtë të bart në pakon e tij vetëm programet televizive për të cilat posedon marrëveshje për ritransmetim të kanaleve përmes rrjetit kabllor.
8. Nëse pas marrjes së licencës, operatori kabllor N.T.P. "Kumanova" siguron marrëveshje shtesë apo të reja për ritransmetimin e programeve në rrjetin kabllor, KPM pas pranimit të kontratave të reja, do të zgjerojë listën e programeve Të kandidatit. Operatori kabllor N.T.P. "Kumanova" obligohet t'i ofrojë KPM-së të gjitha marrëveshjet e reja, sapo t'i ketë siguruar ato.
9. KPM vlerëson se N.T.P. "Kumanova" ka paraqitur aplikacionin në pajtim me kriteret e përcaktuara me Rregulloren CIMC 2007/04 si dhe me rregulloren për Marrjen e Licencës së KPM-së (CIMC 2009/02).
10. Prandaj, Këshilli i KPM-së vlerëson se në bazë të nenit 6 të Rregullores CIMC 2007/04 operatori kabllor N.T.P. "Kumanova" ka përmbushur kriteret për kualifikim për licencë të KPM-së.

Vendim

11. Këshilli i KPM-së konkludon se N.T.P. "Kumanova" ka aplikuar për licencë të KPM-së dhe ka ofruar të gjitha të dhënat e nevojshme për të ofruar shërbime të programeve kabllore përmes sistemit kabllor në Dragash.
12. Këshilli i KPM-së vendos që operatorit kabllor N.T.P. "Kumanova", i cili planifikon të operojë në Therandë, t'i lëshoj licencën e KPM-së për të ofruar përmes sistemit kabllor shërbime të programeve kabllore për të cilat posedon marrëveshje për ritransmetim të kanaleve përmes rrjetit kabllor.
13. Në bazë të Nenit 3.2 të Rregullores për Distribuim Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë, licenca e operatorit kabllor N.T.P. "Kumanova" do të jetë valide për një periudhë prej dhjetë (10) vitesh, me mundësi vazhdimi nga ana e KPM-së.
14. Në pajtueshmëri me Nenin 10 të Rregullores CIMC Nr. 2007/4, çdo operator kabllor duhet të paguajë taksën vjetore. Niveli i taksës vjetore për licencim të Operatorëve Kabllorë është i përcaktuar me Nenin 3.1 të Vendimit për Nivelin, Mënyrën e Përcaktimit të Pagesës së Takës për Licencim të Operatorëve Kabllor dhe Ofruesve të Shërbimeve të Programeve përmes Kabllor (CIMC 2007/05).
15. Në pajtueshmëri me Nenin 6.2 të Vendimit (CIMC 2007/05), operatori kabllor N.T.P. "Kumanova" duhet ta paguaj taksën e parë vjetore për licencë jo më vonë se 14 ditë pas pranimit të vendimit për licencim.

16. Operatori kabllor N.T.P. "Kumanova", mund të fillojë shpërndarjen e listës së programeve vetëm pas nënshkrimit të Pakos së Licencës së KPM-së.

Lëshimi i Vendimit

17. Këtë vendim e lëshon Këshilli i KPM-së.




Filloreta Bytyçi
Kryesuese e Këshillit të KPM-së.

27/9/2010
datum

Vërtetim

Me këtë vërtetohet se Këshilli i KPM-së ka marrë këtë vendim në pajtueshmëri me rregulloret dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë, dhe në pajtueshmëri me rregullat e procedurës së KPM-së.



Naife Selimaj Krasniqi
Shefe Ekzekutive



27.09.2010
datë